THIRRJE E HAPUR PUBLIKE PËR BRENDIMIN E RTK-së

Rreth RTK- së:

RTK është transmetuesi i vetëm publik, i themeluar në shtator të vitit 1999. RTK ka 4 kanale televizive dhe 2 radio stacione me frekuencë nacionale. Përgjatë 23 viteve të themelimit, RTK është ribrenduar dy herë, gjithmonë duke ruajtur konsistencën dhe imazhin e mediumit publik.

RTK mbulon ngjarje, tema e debate që nuk kanë vlerë komerciale por që janë në interes të shoqërisë, të komuniteteve të caktuara dhe të grupeve të margjinalizuara.

Kërkesat dhe objektivat:

Si pjesë e përpjekjeve tona të vazhdueshme ndër vite për të evoluar krahas kërkesave të kohës dhe audiencës sonë, ne po rifreskojmë identitetin vizual të platformave tona televizive, kanaleve të radios dhe të medias online.

Ribrendimi i imazhit të RTK-së duhet të bëhet në një formë shumë të kujdesshme, duke ruajtur imazhin e mediumit publik dhe gjithashtu duke sjellë një frymë të re dhe moderne. Ribrendimi duhet të përçojë tek audienca mesazhin kryesor të transmetuesit publik, cilësi dhe qasje të lehtë në përmbajtje kualitative për të gjithë, qasje në formatin dhe pajisje të ndryshme, përmbajtje informuese, argëtuese dhe edukative për publikun. Ribrendimi i imazhit vizual të RTK-së duhet të pasqyrojë frymën e komunitetit, llojllojshmërinë dhe përmbajtjen cilësore të programit tonë. I njëjti duhet të përfshijë akronimin e emrit të Radiotelevizionit të Kosovës, duke u siguruar që ai të jetë pjese përbërëse e dizajnit të përgjithshëm.

Shërbimet e kërkuara:

a) Logoja

RTK

Radiotelevizioni i Kosovës
Radio Televizija Kosova
Radio Television of Kosovo

RTK1 RTK2 RTK3 RTK4 RADIO KOSOVA 1 RADIO KOSOVA 2 ONLINE

Logoja duhet t`i pasqyrojë vlerat e Radiotelevizionit të Kosovës, të jetë e thjeshtë dhe lehtësisht e dallueshme, gjithsesi duke reflektuar identitetin e mediumit dhe rolin e rëndësishëm në komunitet.
Duhet të theksohet rëndësia e origjinalitetit, duke u siguruar që logoja të jetë unike dhe të shmangë çdo ngjashmëri me logot ekzistuese, të përfshijë akronimin e emrit të Radiotelevizionit të Kosovës, duke u siguruar që të jetë pjesë integrale e dizajnit të përgjithshëm.
Duhet kujdesur për përshtatshmërinë e logos për përdorim në kontekste të ndryshme, duke

përfshirë grafikat në ekran, materialet promovuese dhe platformat digjitale, duke i konsideruar si sfondet e bardha, ashtu edhe ato të errëta.
Duhen ofruar opsione shtesë të logos për ditë të rëndësishme si: 17 Shkurt, 28 Nëntor, për festat e fundvitit dhe për dite zie.
Duhet të siguroheni që logoja të komunikojë në mënyrë efektive një imazh të qartë dhe koherent, në përputhje me vlerat dhe misionin e RTK-së. Preferohet që logoja të jetë e riprodhueshme në të zezë dhe në të bardhë, duke lejuar përdorimin efektiv në materialet e fotokopjuara ose reklamat bardhë e zi, duke ruajtur ndikimin e saj vizual.
Duhet përshkruar qartë ku dhe si duhet të përdoret logoja, përfshirë platformat digjitale, materialet e shtypura dhe grafikat në ekran gjatë transmetimeve. Identifikojini specifikat për variacione të ndryshme të logos (horizontale, vertikale, e ndarë) dhe sigurohuni që janë optimizuar për aplikacione të ndryshme dhe media online. Përcaktojeni madhësinë minimale dhe maksimale të logos, për të ruajtur shikueshmërinë dhe qartësinë në kontekste të ndryshme.

Motoja/slogani

Duhet të realizohet një frazë e shkurtër, tërheqëse dhe e paharrueshme për të komunikuar idenë thelbësore të brendit.

b) Brand book (Udhëzuesi Grafik i Brendit)

Udhëzuesi grafik i brendit (Brand Book) duhet t`i përfshijë udhëzimet në pamjen dhe ndjesinë e dizajnit të ri të brendit, duke përshkruar ngjyrat, shkronjat, elementet standarde për shtyp, fletushkat, dokumentet, pankartat dhe produktet e tjera, duke treguar se si elementet vizuale të brendit duhet të përdoren dhe të shfaqen në media të ndryshme.

c) Tipografia

Të krijohet ose përzgjidhet një font i veçantë si pjesë përbërëse e identitetit vizual të RTK-së. Duhen përcaktuar shkronjat primare dhe sekondare për grafikat në ekran, duke siguruar lexueshmëri në madhësi të ndryshme të ekranit. Përcaktojini shkronjat primare për përdorim në ueb. Specifikoni udhëzime për madhësi shkronjash në grafikat televizive dhe kushtet për lexueshmëri opti

d) TV Ident Promo

Identet janë një mënyrë krijuese për të promovuar një kanal televiziv, ato janë mjaft të shkurtra në kohëzgjatje, por megjithatë përcjellin një identitet të markës së stacioneve televizive. Të paraqitet animacioni i TV Identit për RTK 1, 2, 3 dhe 4, përfshirë edhe animacionin marketing për kanalet e lartpërmendura me kohëzgjatje prej 5 sekondash.

e) Animacioni i promove programore:

Të prezantohen pamjet e promove programore në versionet: SË SHPEJTI, E HËNË, SOT DHE PAS PAK, duke planifikuar paraqitjen e elementeve si: logoja e kanalit televiziv, DITA, ORA, PËRSHKRIMI I PROGRAMIT dhe një vend opsional për shënime të tjera.

f) Uebsite dhe Media Online:
Dëshirojmë të punojmë me një ekip të aftë dhe të kualifikuar për të krijuar dizajn të avancuar, modern dhe lehtë për t'u naviguar, me funksione të përshtatshme për pajisjet mobile, të integruara me media sociale. Kompanitë të cilat janë të interesuara të ofrojnë shërbime për ridizajnimin dhe zhvillimin e uebfaqes për rtklive.com duhet t`i plotësojnë kushtet si në vijim:
Shërbimi i konsulencës:
- Portali është i bazuar në uebmenaxhim të të dhënave. Duhet të zhvillohet Sistemi për Menaxhimin e Përmbajtjes (CMS), që do të mundësojë publikimin, modifikimin apo fshirjen e çfarëdo përmbajtjeje në portal.
- Të jetë funksional në gjuhët: shqip, anglisht, serbisht, turqisht, boshnjakisht dhe rome.
- Të realizohet migrimi i databazave aktuale me dizajn të ri.
- Integrimi i teknologjive të fundit për të shtuar funksionalitet dhe siguri.
- Kandidatët duhet të kenë portofolio të ndërtuar në të kaluarën, që tregon njohuritë dhe aftësitë e tyre në këtë fushë.
- Të posedojnë së paku tri referenca - portale të kategorisë së lartë në trafik 200.000 + vizita në ditë.
- Të jetë operativ në tregun e Kosovës së paku në katër vitet e fundit.
- Të sigurohet një dizajn tërheqës dhe miqësor për përdoruesit

- Të prezantohet uebfaqja në përdorim: Desktop, Tablet dhe Telefon.

Mbështetja teknike:
- Vënia në dispozicion 24 orë - 7 ditë në javë, e stafit të kualifikuar, i cili është i qasshëm përmes postës elektronike dhe linjës së dedikuar telefonike.

Media Online

-Të realizohet fotografia e profilit (cover photo) në platformat e mediave sociale (Facebook, Instagram, Twitter, Youtube), duke siguruar që ato përputhen me brendin në përgjithësi.

-Të jepen udhëzime kreative për krijimin e përmbajtjes vizuale tërheqëse të postimeve nëpër platforma të ndryshme online, ku të njëjtat janë të dukshme.

Kompanitë pjesëmarrëse duhet të dërgojnë 1(një) deri në 2(dy) koncepte kreative të shërbimeve. Ato duhet t`i përgatisin të gjitha materialet e kërkuara në këtë thirrje dhe së bashku me to të dërgojnë edhe portofolion/dosjen e kompanisë dhe punët e tjera relevante me këtë kërkesë. Kompania e përzgjedhur ka obligim që materialet e propozuara t’i ndryshojë ose modifikojë varësisht kërkesave paraprake të RTK-së.

Vlera maksimale për ideimin dhe realizimin e kësaj thirrjeje publike është 24,000 €.

RTK ka të drejtë të kërkojë edhe sqarime dhe dokumentacion shtesë nga kompanitë ofertuese nëse është e nevojshme, në mënyrë që vlerësimi të jetë sa më i saktë.

Kërkesa për shprehjen e interesit/projekt ideor, duhet të dorëzohet në kuvertë të mbyllur, duke filluar nga 27.12.2023 deri më 31.01.2024 në orën 16:00, në Zyrën e Administratës nr. 71 në ndërtesën e Radiotelevizionit të Kosovës, në adresën: Rr "Xhemajl Prishtina", nr. 12 - Prishtinë. Propozimet do të ftohen për prezantim te komisioni.
Projekti më i mirë ideor (fitues) do t`u nënshtrohet procedurave ligjore të prokurimit publik dhe më pas kompania fituese do ta bëjë realizimin e projektit.
Për çdo informatë shtesë, mund të kontaktoni përmes adresës elektronike:
administrata@rtklive.com